



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1449/24 Datë: 23.07.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 125-të, mbajtur me datë 03.07.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Termoenergjetika dhe Energji e Ripërtëritshme, BSc 180 ECTS, me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik;*
- II. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 - *Komunikacion Rrugor, MSc 120 ECTS me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës, për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në UP brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtëritshme, BSc 180 ECTS R</i>	Rexhep Selimaj Bedri Dragusha Drenusha Krasniqi Alidema
2.	<i>Komunikacion Rrugor, MSc 120 ECTS R</i>	Ramadan Mazrekaj Ferat Shala Fitore Abdullahu Shaban Buza

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Prishtinës.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtëritshme, BSc 180 ECTS***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Francisco Farfan, Tea Marohnic dhe Arnoldas Solovjovas, është organizuar më 27.05.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3), ndërsa Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Komunikacion Rrugor, MSc 120 ECTS***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Tea Marohnic, Francisco Farfan, dhe Arnoldas Solovjovas, është organizuar më 27.05.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5) dhe Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 125-të, të mbajtur më datë 03.07.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet;
Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në UP;
MASHTI;
Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë